Sweden
Sverige

SALAR International
A part of the Swedish Association of Local Authorities and Regions

MANUAL
për mbrojtjen nga zjarri në deponi



Manual
për mbrojtjen nga zjarri në deponi

Autorët:
Vladimir Simonovski, ekspert kombëtar për mbrojtjen nga zjarri
Per-Olof Hallberg, ekspert ndërkombëtar i menaxhimit të mbeturinave

Ekipi redaktues:
Emil Angelov dhe Martin Nikoliq


Dizajni i publikimit:
Brigada dizajn

Fotot e kopertinës:
Goran Angeloski

SALAR International bëri përpjekje të arsyeshme për të siguruar që të dhënat, analizat, opinionet dhe informacionet e tjera të përdorura në manual të jenë të sakta. Edhe pse të mbledhura nga burime që besohet të jenë të besueshme, SALAR International pranon se saktësia e të dhënave ose informacionit të përdorur nuk mund të garantohet. Plotësia dhe saktësia e të gjitha të dhënave dhe informacionit të përdorur për prodhimin e manualit varet nga burimet e këtyre të dhënave dhe informacionit, të cilat janë jashtë kontrollit të SALAR International.

SALAR International do të donte të falënderonte të gjitha institucionet dhe individët që morën pjesë në manual për mbështetjen dhe kontributin e tyre të pa rezervë. ©SALAR International, 2025. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

SALAR International



Pse është i rëndësishëm mbrojtja nga zjarri në deponi?

Parandalimi i zjarrit në deponitë komunale është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe asgjësimin e sigurt të mbeturinave. Zjarret në deponi janë të rrezikshme, duke lëshuar gazra toksikë dhe ndotës që dëmtojnë mjedisin jetësor dhe shëndetin publik. Pasi ndizen, ato janë tepër sfiduese për t'u shuar, duke konsumuar burime dhe duke shkaktuar ndotje të gjerë. Parandalimi i zjarreve mbron punëtorët, banorët dhe mjedisin lokal.

Deponitë e pakontrolluara, si shumica në vend, përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për shkak të mungesës së masave parandaluese dhe mbikëqyrjes. Pa parandalimin e strukturuar të zjarrit, këto vende janë të ndjeshme ndaj rreziqeve nga mbetjet e ndezshme, gazi metan dhe djegia spontane, veçanërisht gjatë muajve të nxehtë të verës. Mbeturinat e pakontrolluara dhe të pandara rrisin rrezikun e ndezjes, duke çuar në incidente për përhapjen e shpejtë të zjarreve. Ndryshimi i klimës dhe moti i ngrohtë i përkeqësojnë këto rreziqe, duke krijuar kushte ideale për zjarret në deponi.

Në Maqedoninë e Veriut është vërejtur një rritje e konsiderueshme e zjarreve në deponi kohët e fundit, që i atribuohen kushteve më të ngrohta dhe mungesës së menaxhimit të kontrolluar të mbetjeve. Rajoni planor i Pellagonisë dhe rajoni planot Jugperëndimor, fokusi i këtij studimi që rezulton në këtë Manual, kanë përjetuar zjarre të shumta në deponi që ndikojnë në mjedis dhe komunitetet. Një deponi e re rajonale është planifikuar të zëvendësojë afërsisht 15 deponi ekzistuese që nuk i përmbushin standardet. Këto deponi aktuale shpesh nuk kanë mbrojtje adekuate nga zjarri, duke i bërë ato jashtëzakonisht të rrezikshme.

Zbatimi i masave për mbrojtje nga zjarri është thelbësor për minimizimin e rreziqeve mjedisore dhe të shëndetit publik. Kjo mbështetet nga numri gjithnjë e më i madh i zjarreve në deponi në Maqedoninë e Veriut që është rritur ndjeshëm në mbi 1,500 incidente të raportuara vetëm në vitin 2023. Këto shifra alarmante janë thirrje për një zbatim të menjëhershëm të masave parandaluese në të gjitha deponitë në vend.







Gjetjet e vlerësimit

Vlerësimi i pesë deponive të përdorura nga gjashtë komunat pilot zbuloi sfida të përbashkëta. Të gjitha deponitë e vlerësuara nuk përputhen me rregulloret e BE-së për deponitë dhe duhet të klasifikohen si "vende për grumbullimin e mbeturinave".

Sfidat e përgjithshme në të gjitha deponitë:

- **Transporti i mbeturinave të paracaktuara:** Transferimi i mbeturinave të përziera në kamionë rrit gjasat e zjarrit për shkak të pranisë së materialeve të djegshme.

- **Vendet për hedhjen e mbeturinave:** Vendet specifike ku depozitohen mbeturinat kontribuojnë në rreziqet nga zjarri, veçanërisht pasi nuk menaxhohen në mënyrë përkatëse.

- **Përqendrimi i mbeturinave:** Praktika e hedhjes së vëllimeve të mëdha të mbeturinave në një zonë rezulton në formimin e grumbujve të mëdhenj të mbeturinave, duke rritur rreziqet nga zjarri.

- **Avullimi i lëndëve djegëse fosile të ndezshme:** Akumulimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave mund të rezultojë në avullimin e lëndëve djegëse fosile lehtësisht të ndezshme, duke rritur më tej rrezikun nga zjarri.

- **Mungesa e masave monitoruese dhe parandaluese:** Mungesa e mekanizmave efektivë për monitorim dhe strategjive për parandalimin e zjarreve rrisin potencialin për shpërthime zjarri.

- **Rreziqet e vetë-ndezjes:** Rrezik i konsiderueshëm për shkak të hirit të nxehtë, qymyrit të padjegur dhe pranimit të përditshëm të mbeturinave elektronike (përfshirë bateritë e litiumit). Dekompozimi i mbeturinave dhe temperaturat e larta të ambientit gjenerojnë nxehtësi.

- **Sfidat në shuarjen e zjarreve:** Shuarja është komplekse dhe e zgjatur; menaxhimi jo përkatës rezulton me tym nga zjarri dhe ri-ndezje. Rrugët hyrëse dhe rrugët e brendshme shpesh janë të pamjaftueshme dhe të bllokuara. Nevojiten sasi të mëdha uji dhe nuk ekzistojnë pellgje të specializuara ose rezervuarë rrjedhës.

- **Ndryshimet klimatike dhe ndikimet e motit më të nxehtë:** Ditët me diell në rritje dhe temperaturat në rritje kontribuojnë në frekuencë më të lartë ndezjeje dhe djegie të zgjatur.

- **Masat e pamjaftueshme të sigurisë:** Shumica e deponive kanë siguri minimale deri në jo-ekzistente, mungojnë gardhet, portat, monitorimi dhe personeli.

- **Mungesa e Planeve për Vlerësimin e Rrezikut:** Planet për vlerësimin e rrezikut nga zjarri mungojnë në përgjithësi.

- **Mungesa e klasifikimit dhe matjes së mbeturinave:** Shumica e deponive nuk kanë makina për klasifikim, ndërsa emetimet e gazit maten rrallë.

Sfidat specifike:

- **Komuna e Kërçovës:** Deponia e vjetër ndodhet në qendër të qytetit, duke paraqitur rrezik të konsiderueshëm për ndërtesat dhe strukturat e afërta nëse ndodh një zjarr. Është çaktivizuar zyrtarisht, por ende përdoret. Ekzistojnë edhe deponi të paligjshme, njëra prej të cilave është veçanërisht e madhe dhe paraqet një rrezik serioz për shkak të afërsisë me një impiant për trajtimin e mbeturinave të ujit, një lumë dhe një mal.

- **Komuna e Pllasnicës:** Kjo komunë nuk ka njësi të zjarrfikësve, duke u mbështetur në njësitë nga komunat fqinje (Makedonski Brod, 12 km; Kërçovë, 18 km) gjë që rrit kohën e ndërhyrjes. Megjithatë, punësimi i një kujdestari komunal ka rezultuar me rënie të incidenteve nga zjarret (vetëm dy në vitin 2023).

- **Komuna e Ohrit:** Deponia e Bukovës ndodhet në një zonë malore 20 km nga qyteti, duke e bërë qasjen sfiduese. Gjatë sezonit turistik, mbetjet ditore rriten ndjeshëm (deri në 100 ton). Rreziqet e zjarrit janë dukshëm më të larta këtu për shkak të vëllimeve të mëdha të mbeturinave në verë, temperaturave të larta dhe mbeturinave lehtësisht të ndezshme që shkaktojnë vetë-ndezje. Koha e parashikuar e mbërritjes për njësinë e zjarrfikësve të Ohrit është mbi 30 minuta për shkak të

distancës dhe terrenit të vështirë. Zjarret ditore ndodhin pothuajse çdo ditë në verë dhe vendosja e automjetit të vetëm zjarrfikës komunal në Bukovë rrezikon sigurinë e Ohrit. Deponia është e rrethuar me bimësi masive pyjore, duke rritur rrezikun e zjarreve katastrofike të pyjeve.

- **Komuna e Prilepit:** Kjo deponi është në gjendje më të mirë sa u përket masave parandaluese. Ajo ka një shërbim sigurie 24 orë në portë dhe janë ndërtuar dy rrugë shërbimi për qasjen e departamentit të zjarrfikësve. Aktivitetet për një plan për vlerësimin e rrezikut kanë filluar dhe mbeturinat lehtësisht të ndezshme si tekstilet po zgjidhen. Komuna ka filluar ndërtimin e një objekti për përzgjedhjen e mbeturinave në hyrje të deponisë, i cili pritet të zvogëlojë ndjeshëm vëllimin e mbeturinave dhe rreziqet nga zjarri pasi të jetë funksional.

- **Komunat Manastir dhe Novaci (Deponia Meglenci):** Rreziku më serioz i sigurisë është kalimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike nga REK Manastir mbi deponinë në një lartësi jo më shumë se 15 metra, duke paraqitur rreziqe të konsiderueshme zjarri dhe sigurie. Deponia përdoret nga tre komuna (Manastir, Novaci, Mogillë) dhe përdoret gjithashtu nga një kompani private nga REK Manastir për asgjësimin e mbeturinave, pa asnjë mekanizëm për të përcaktuar sasinë e mbeturinave që ata hedhin. Shërbimi i sigurisë është në dispozicion vetëm deri në orën 14:00.





Rekomandime

Rekomandime të përgjithshme

Veprimet gjatë zjarreve në deponi

Kur adresojmë zjarret në vendin e deponisë, është thelbësore të identifikojmë strategji efektive për reagim dhe të pranojmë çdo mungesë në aftësi ose burime që mund të pengojnë përpjekjet. Rekomandohet që komunat të zbatojnë sa më poshtë:

- **Parandalimin e dëmtimit të mjedisit**: Zhvilloni strategji për të minimizuar ndikimet negative në mjedis.
- **Vlerësimi i rrezikut**: Vlerësoni rreziqet që lidhen me operacionet e shpëtimit.
- **Menaxhimi i sekuencës së ngjarjeve**: Zbatimi i masave për të shuar dhe kontrolluar përparimin e zjarrit.
- **Filloni operacionet e shpëtimit**: Krijoni protokolle të qarta për fillimin e përpjekjeve për shpëtim.
- **Shfrytëzimi i burimeve**: Kuptoni se si të përdorni në mënyrë efektive burimet e disponueshme dhe çfarë përpjekjesh specifike kërkohen.

Masat parandaluese dhe gatishmëria:

- Sigurohuni që të keni njohuri të plota mbi planin e deponisë, bashkëpunoni me personelin operacional dhe ofroni trajnim gjithëpërfshirës.
- Angazhoni shërbimet e shpëtimit (zjarrfikësët) në planifikimin e organizimit të deponisë në qeliza/zona të veçanta për zjarrfikje efektive.

Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor: Angazhoni inspektorët e mjedisit jetësor ose autoritetet rajonale për të diskutuar rreziqet e mundshme nga zjarret dhe kryeni vlerësime pas zjarrit për efektet dhe efektivitetin e operacionit të shpëtimit. Pikat kryesore përfshijnë:

- Metodat për shuarjen e zjarrit: Përcaktoni teknikat e duhura për shuarjen e zjarrit.
- Trajnimi i nevojshëm: Identifikoni nevojën për trajnim për personelin e përfshirë në përpjekjet e shuarjes së zjarreve.

- **Qasja në pajisjet për monitorimin e emetimeve:** Brigadat e zjarrfikësve dhe operatorët e deponive duhet të kenë qasje në mjete për të ndjekur luhatjet e gazit të zjarrit dhe për të përcaktuar kur kushtet janë shumë të rrezikshme për personelin.

- **Sigurimi i pajisjeve dhe personelit:**
  - Sigurohuni që makineritë dhe operatorët e trajnuar të jenë në dispozicion për kontrollin dhe shuarjen e shpejtë.
  - Kryeni përgatitje bashkëpunuese dhe skenarë të rregullt trajnimi me pronarët e deponive (kompanitë e shërbimeve) dhe ekipet për shuarjen e zjarreve (shërbimet e zjarrfikësve).

- **Ripërdorim i ujit për shuarje:** Analizoni potencialin për ripërdorimin e ujit të përdorur në shuarjen e zjarreve për të zvogëluar sfidat e riparimit.

- **Disponueshmëria e materialeve për mbulim:** Vlerësoni mjaftueshmërinë e tokës në vend, rërës ose materialeve të tjera për të shuar zjarret dhe për të zvogëluar rrjedhën e oksigjenit. Zbatoni praktikat e përditshme për mbulim për mbeturinat e ekspozuara për parandalimin e zjarrit.

- **Pajtueshmëria rregullatore dhe bashkëpunimi:** Deponitë duhet të funksionojnë sipas lejeve përkatëse dhe t'i përmbahen legjislacionit kombëtar. Mbrojtja efektive nga zjarri kërkon bashkëpunim midis brigadave të zjarrfikësve, operatorëve të deponive, kompanive të shërbimeve dhe inspektorëve të mjedisit, me përpjekje të përshtatura për secilin objekt.

- **Përmirësimi i vazhdueshëm:** Kryeni vlerësime pas çdo incidenti zjarri në deponi për të përmirësuar përpjekjet e ardhshme për reagim dhe për të përfshirë të gjithë palët e interesuara që kanë marrë pjesë në operacionet e shpëtimit për të identifikuar fushat për përmirësim.





Rekomandime specifike

Mbrojtja nga zjarri dhe menaxhimi:

- Pajisni deponitë me pajisje adekuate për shuarjen e zjarrit.
- Siguroni trajnim gjithëpërfshirës për të gjithë punonjësit e deponisë përgjegjës për sigurinë, duke u përqëndruar në menaxhimin e zjarrit dhe procedurat e shuarjes.

Masat proaktive për parandalimin e zjarrit:

- Zhvilloni plane të përshtatura për deponinë për menaxhimin e rrezikut për kompanitë/personat juridikë menaxhues.
- Përcaktoni dhe ndani qartë zonat e deponisë (qelizat/zonat) për llojet specifike të mbeturinave.
- Instaloni sisteme të zbulimit të gazit për të matur nivelet e përqendrimit të gazit, veçanërisht gjatë temperaturave të larta.
- Ndaloni asgjësimin e materialeve lehtësisht të ndezshme në zona me përqendrim të lartë të gazit.
- Siguroni rrugë të shumta hyrëse në deponi dhe rrugë të brendshme për lëvizje të papenguar të automjeteve zjarrfikëse.
- Nxitni përgjegjësi më të madhe në menaxhimin e deponive, duke theksuar protokollet e kontrolluara të hyrjes dhe qasjes.
- Vendosni sisteme monitorimi, duke përfshirë ndriçimin dhe rrethimin perimetrik, për të parandaluar hyrjen e paautorizuar dhe zjarr vënien e mundshme.
- Vendosni një ekip sigurie me automjete patrullimi për monitorimin e vazhdueshëm 24-orësh të perimetrave të deponisë.
- Blini makina për klasifikimin e mbeturinave lehtësisht të ndezshme si plastika dhe letra.
- Caktoni sektorë të veçantë për deponimin e mbeturinave, duke siguruar qasje në kohë për ndërhyrje për të parandaluar përhapjen e zjarrit.
- Ndërtoni sektorët e mbeturinave si gropa të thella që mund të mbulohen shpejt me tokë kur mbushen (vrima me mbulesë të shpejtë).
- Instaloni sisteme për monitorim termik (kamera termike) për të zbuluar tymin dhe për të aktivizuar alarmet kur zbulohet nxehtësia.

Udhëzime për një Plan të Thjeshtuar për Menaxhimin e Zjarrit: Rregulloni lëvizjen individuale në deponi dhe parandaloni ndezjet e qëllimshme për të zvogëluar incidentet e zjarrit (potencialisht deri në 80%). Caktimi i një rojtari komunal për patrullime të rregullta dhe monitorim, siç shihet në Komunën e Pllasnicës, mund të zvogëlojë ndjeshëm zjarret duke zbatuar dënimet për hedhjen e paligjshme.

Raportimi, komunikimi dhe shpërndarja e udhëzimeve:

- **Angazhimi i komunave dhe shërbimeve**: Rritja e bashkëpunimit me komunat dhe kompanitë për shërbime publike për të informuar banorët dhe bizneset për praktikat e sigurta të hedhjes së mbeturinave përmes kanaleve zyrtare dhe mediave sociale.
- **Organizimi i ngjarjeve për pastrim:** Planifikoni iniciativa për mbledhjen e mbetjeve nga ndërtimet dhe mbeturinave të mëdha, duke përshkruar qartë oraret e mbledhjes për të minimizuar hedhjen e paligjshme.
- **Rritja e disponueshmërisë së kontejnerëve për mbeturina:** Instaloni më shumë kontejnerë mbeturinash dhe kosha për selektim të mbeturinave nëpër komuna për të inkurajuar praktikat e duhura për asgjësim të mbetjeve.
- **Kryeni fushata ndërgjegjësimi**: Zbatoni fushata të rregullta për të edukuar komunitetet lokale rreth rreziqeve që lidhen me zjarret e pakontrolluara në kosha, kontejnerë dhe deponi, duke përdorur fletushka dhe billborde.





Lista për vetë-vlerësim për mbrojtjen nga zjarri në deponi

(hapat që operatori i deponisë duhet të kalojë për të vlerësuar kapacitetin e tij për të operuar ligjërisht dhe në mënyrë të sigurt deponinë)

Zona tematike	Po/Jo	koment
Mbështetje këshillimore dhe konsultime		
A jeni njohur me ndonjë rregullore për siguri nga zjarri në deponinë tuaj?		
A keni qasje në person për konsultim për sigurinë nga zjarri ose vlerësimin e rrezikut?		
A jeni konsultuar me njësinë/shërbimin e zjarrfikësve për ndonjë këshillë në lidhje me sigurinë/mbrojtjen nga zjarri në deponinë tuaj?		
A jeni konsultuar me inspektorin e mjedisit jetësor në lidhje me sigurinë/mbrojtjen nga zjarri në deponinë tuaj?		
A janë marrë këshilla nga autoritetet/personat përgjegjës të përfshira në planin e sigurisë nga zjarri?		
Vlerësimet dhe planet		
A keni kryer një vlerësim të rrezikut nga zjarri për deponinë tuaj?		
A përfshin vlerësimi mbrojtjen e njerëzve, mjedisit dhe pronës?		
Bazuar në vlerësimin, a keni zhvilluar një plan për kontrollin e rrezikut nga zjarri? Nëse po, a po e përdorni planin?		
A përfshin plani aspekte të tilla si pajisjet për fikjen e zjarrit dhe udhëzime për punonjësit?		
A përfshin plani udhëzimet e sigurisë nga zjarri që departamenti i zjarrfikësve duhet të ndjekë në rast zjarri?		
A përfshin plani të gjitha burimet e ndezshme (rezervuarët, cilindrat e gazit, etj.)?		
Vendndodhja dhe strukturat në afërsi		
A ka shkolla, spitale, ndërtesa banimi ose objekte të tjera të infrastrukturës në afërsi të deponisë që mund të preken nga një zjarr i deponisë?		
A mund të ketë zjarri në deponi një efekt katastrofik në një vend të afërt (stacion karburanti, depo materialesh të djegshme)?		
Cila është koha e përgjigjes së departamentit më të afërt të zjarrfikësve në rast të një zjarri në deponi?		
Çfarë ndodh nëse departamenti më i afërt i zjarrfikësve nuk mund t'i përgjigjet thirrjes?		

Zona tematike	Po/Jo	koment
Shkaqet e zakonshme të zjarrit dhe masat paraprake		
A janë identifikuar të gjitha burimet e mundshme të zjarrit në deponi, duke përfshirë pajisjet e ndriçimit, ngrohjes dhe gatimit?		
A ndalohet pirja e duhanit në deponi dhe a zbatohet ky ndalim?		
A kryeni inspektime rutinore të zjarrit në deponi?		
A keni masa adekuate të sigurisë së deponisë për të zvogëluar rrezikun e zjarr vënies?		
A keni kontroll mbi llojin e mbeturinave që shkojnë në deponi? A përfundojnë materialet e ndezshme si boja, holluesit, bateritë etj. në deponi?		
A janë punonjësit e deponisë të njohur me masat paraprake të sigurisë nga zjarri?		
A ka aparate për shuarjen e zjarrit dhe pajisje të tjera të mbrojtjes nga zjarri në deponi?		
A dinë ta përdorin punonjësit?		
A ka deponia qasje në ujë (rrjetit kryesor të ujësjellësit ose rezervuar) dhe a është i përshtatshëm për rrezikun e mundshëm nga zjarri?		
A mund të hyjë lehtësisht kamioni i zjarrfikësve në të gjitha pjesët e deponisë?		
A e dinë punonjësit se çfarë të bëjnë në rast zjarri?		
A ka një tabelë informimi në deponi (emri i objektit, numri i urgjencës, orari i hapjes, lista e mbeturinave të pranueshme)?		





Lista e kontrollit ditor për mbrojtjen nga zjarri në deponi

(hapat që roja/stafi i deponisë duhet të kalojë çdo ditë ndërsa janë të pranishëm në deponi)

Siguria e perimetrit:	Shënoni nëse është kontrolluar
1. Sigurohuni që të mos ketë pika të paautorizuara të hyrjes ose shkelje në perimetrin ku zakonisht do të ishte një gardh.	
2. Vendosni barriera ose shenja të përkohshme në hyrje për të parandaluar hyrjen e paautorizuar dhe kontrolloni çdo ditë nëse shenjat/barrierat janë në vend.	
Monitorimi dhe vëzhgimi i vazhdueshëm:	
3. Kryeni një patrullë të rregullt (të paktën dy herë në ditë) për të monitoruar çdo lëvizje të paautorizuar të personave brenda deponisë.	
4. Mbani regjistrin ditor të çdo aktiviteti ose individi të dyshimtë rreth deponisë.	
Qasja dhe rrugët:	
5. Sigurohuni që rruga hyrëse të jetë e pastër nga pengesat dhe të lejojë lëvizje të lehtë për automjetet.	
6. Pastroni rregullisht rrugët rreth deponisë për të siguruar që ato të jenë të arritshme për automjetet e urgjencës.	
Klasifikimi i mbeturinave:	
7. Identifikoni dhe ndani materialet lehtësisht të ndezshme në zonat e caktuara, duke u siguruar që ato të jenë larg burimeve të mundshme të ndezjes.	
8. Kontrolloni për ndonjë shenjë të emetimeve të pakontrolluara të gazit dhe adresojini ato menjëherë.	
Masat për parandalimin e zjarrit:	
9. Sigurohuni që çdo burim uji i disponueshëm të jetë funksional dhe i arritshëm për qëllime të shuarjes së zjarrit.	
10. Sigurohuni që të ketë sasi të mjaftueshme të tokës, rërës ose materialit tjetër mbulues.	
11. Verifikoni që çdo pajisje zjarrfikëse në vend është në gjendje të mirë pune.	
Protokollet e përditshme të sigurisë:	
12. Realizoni mbledhje të përditshme me të gjithë stafin e deponisë për të shqyrtuar protokollet e sigurisë dhe çdo vëzhgim të ri.	
13. Sigurohuni që lista e kontakteve në rast urgjence të jetë e përditësuar dhe lehtësisht e arritshme për të gjithë anëtarët e stafit.	
Ambienti përreth:	
14. Kontrolloni zonën përreth (pyllin, pemët, bimësinë, materialin e ndezshëm) për çdo shenjë të rreziqeve nga zjarri ose kërcënimeve të mundshme.	
15. Pastroni rregullisht çdo bimësi të ndezshme pranë perimetrit të deponisë për të zvogëluar rrezikun nga zjarri.	





Република Северна Македонија
Министерство за животна средина и просторно планирање

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Република Северна Македонија
Министерство за локална самоуправа

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

ЗЕЛС BNJVL